



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLICA KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIC
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-izlazna

Nr. -1-25

Data 21.02.2020

Br.

Datum

OBILIC-OBILIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilic - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 43 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 47, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 48.3 të Statutit të Komunës si dhe nenit 21 të Rregullores së punës së Kuvendit thërras:

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës (Legjislatura e VI³⁴, mbledhja e 2) me dt.28.02.2020 (e premte) në ora 10:00, në sallën e Kuvendit komunal me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Planit të punës së Kryetarit për vitin 2020
4. Shqyrtimi i kërkesës së DEFZH-së, për bartjen e mjeteve nga viti 2019-2020
5. Shqyrtimi i kërkesës së DKA-së
6. Shqyrtimi i Propozim Vendimeve të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë në Zonën Industriale në Llazarevë
 - a) Investitori : NPT " Medruplast "
 - b) Investitori : " Elite O.P "
 - c) Investitori : " Baruti Group SH.P.K "
7. Shqyrtimi i kërkesave
8. Të ndryshme



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Gërguri



Dalës-Izleazna

Nr. -1-24
Br.

Data 21.02.2020
Datum

OBILIQ-OBILIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilic - Municipality Assembly Obilic

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.31.01.2020, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Burim Gërguri (AAK), Labinot Mirena (AAK), Florije Jashari (AAK), Muhamet Mustafa (AAK) Qendresa Dubova (AAK), Enver Gashi (AAK), Shaip Paloja (LDK), Fatmir Bekteshi (LDK), Fatos Kurshumlja, (LDK), Linda Sadiku (LDK), Arbnore Nasufi (LDK), Hysni Mjeku (PDK), Lulzim Sadiku (PDK), Samire Berisha (PDK), Aziz Bici (LVV), Xhezide Dragusha, (LVV), Nora Preniqi (LB), Armend Rushiti (LB), Nazmi Gashi (Nisma), Slavisa Spasic (SL) dhe Dragan Dancetovic (SL).

Të pranishmit tjerë: Ibush Mjekiqi, Nënkyetar i Komunës, Slavisa Jakovljevic, Nënkyetar i Komunës për komunitete, drejtorët komunal, Slavisa Adjancic, shef i ZKKK-së, Sherif Hoti, menaxher i Prokurimit, Ganimete Aliu, zyrtare për barazi gjinore, Avdyl Mustafa, kryesues i Komitetit për komunitete, përf.i USAID-it, përf.i IZHL-së dhe qytetarët e fshatit Sibofc

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i Kuvendit komunal i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i kërkesës së DSHMS-së
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Kuvendit komunal për vitin 2019
5. Shqyrtimi i Planit vjetor të punës së Kuvendit komunal për vitin 2020
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme

Kryesuesi – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës.

Aziz Bici – Para se ta votoj këtë rend dite, duke pasë parasysh aktualitetin dhe shqetësimet e qytetarëve për gurëthyesin në Sibofc, pasi që këtu kemi edhe përfaqësues nga ky fshat, bazuar në kompetencat që na lejon Statuti i Komunës, neni 52 në pajtim me nenin 39 të LVL-së, pika 1.1 dhe 1.2, propozoj dhe kërkoj miratimin nga ansambleistët që si pikë e rendit të ditës të futet çështja e gurëthyesit në Sibofc. Mendoj se nuk mjafton vetëm një informim që është rekomandue të kërkohet si pikë e fundit e rendit të ditës, por kjo duhet të jetë si pikë e veçantë e rendit të ditës, që në mbledhjen e KPF-së, e ka bërë z.Fatmir Bekteshi. Prandaj, meqë i kemi këtu përfaqësuesit e Sibofcit, për të mos ju marrë shumë kohë atyre, duhet të radhitet si pika e tretë e rendit të ditës.

Lulzim Sadiku –Vërtetë po ndjehem keq që bashkëvendësit e mi janë të shqetësuar për pikën e rendit të ditës, që në fakt i kanë shqetësuar atë pjesë dhe nuk i kanë rekomanduar askush që ti kenë të dhënat e sakta. Unë pajtohem me parafolësin që kjo pikë të jetë pika e tretë e rendit të ditës dhe të hudhet në votim për ndryshim të rendit të ditës.

Armend Rushiti – Edhe unë jam i mendimit që kjo pikë të futet në rend dite nga se nuk është ndonjë shqetësim i vogël që të kalon anash. Prandaj, mendoj se duhet ta shqyrtojmë dhe diskutojmë për këtë pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi – Tash e hudhi në votim propozimin e parë rendin e ditës me 7 pika, ashtu si e keni marrë ju me material.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për e miratuan rendin e ditës të cekur më lartë.

Pika e 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Armend Rushiti – Është hera e 4, që po e kërkoj procesverbalin e muajit shtator, cili është problemi.

Kryesuesi – Sqaron se në atë mbledhje nuk ka pasë inçizim, por nëse ka mundësi të kryhet ai procesverbal ne do të ua sjellim. Ju e dini edhe vet se ne vazhdimisht po kemi problem me inçizim.

Lulzim Sadiku – Kërkoj të shenohet kush dhe si voton sepse ka kaluar viti kalendarik dhe nuk është ditë sa janë për, sa janë kundër. Kërkoj edhe njëherë kryesues nga ju me rastin e votimit, që ata të cilët janë kundër të ju figuron emri sepse shumë njerëz në të ardhmen, pastaj mund ta lexojnë procesverbalin dhe të shohin se kush si ka vepruar dhe punuar. Ne kemi shumë telashe me MAPL-në, kemi shumë vendime që na janë kthyer prapa dhe nuk dihet saktë se kush është përgjegjës.

Kryesuesi – Ju mund ti thoni vetëm vërejtjet në procesverbal, nëse keni sepse keni dalë jashtë temës.

Lulzim Sadiku - Unë jam duke folë për procesverbal, e jo në pikën të ndryshme. Pra, kërkoj që në procesverbal të shenohet kush si voton, konkretisht edhe pika që u shtye për qytetarët të mbetet në rend dite Anëtarët e Kuvendit komunal me 15 vota për dhe 6 vota kundër e miratuan ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi – Sqaron se forma e votimit përcaktohet me Rregullore të punës, përveç nëse ligji thotë ndryshe.

Lulzim Sadiku – Ne e dimë Rregulloren e punës, kryesues por ju po bëni shkelje kush si voton.

Pika e 3 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën e DSHMS-së, për bartje të 10 ari tokë në emër të QKMF-së, Obiliq e cila figuron në emër të Shkollës Fillore.

ibush Mjekiqi – Ju siq e dini në vitin e kaluar e kemi paraparë me buxhet ndërtimin e AMF-së, në Breznicë, meqenëse objekti i vjetër nuk i plotëson kriteret për ofrimin e shërbimeve shëndetësore. Unë sot kërkoj nga ju të bëhet ndarja e parcelës dhe të bëhet bartja prej pronës që është në emër të shkollës në emrin e QKMF-së. Kjo na duhet për shkak të nxjerrjes së lejes së ndërtimit për këtë objekt.

Muhamet Mustafa – Mendoj se ndërtimi i këtij objekti shëndetësor është shumë i mirëseardhur për fshatin tonë, por sa i përket parcelës ku është paraparë të ndërtohet objekti propozoj të jetë 15 ose 20 ari sepse sigurisht se do të bëhet gjelbërim rreth objektit. Është një çështje tjetër që unë do të kërkoj sqarim sepse këtu, thuhet të ndërtohet ambulanca e re në vend të objektit ekzistues. Kërkoj që të ndërrohet kjo që thuhet “në vend” dhe të jetë “afër objektit të vjetër” sepse dihet se ai objekt përpara, ka qenë shkollë dhe është një ndër shkollat me të vjetra në Kosovë dhe prej asaj shkolle kanë dalë shumë kuadro. Prandaj, është mirë që ai objekt të mos rrënohet, por të ruhet dhe të destinohet për çështje tjera.

Lulzim Sadiku – Unë në emër të grupit parlamentar të partisë demokratike e përgëzoj për këtë punë që bëhet në fshatin Breznicë dhe a janë shumë pak 10 ari, 15, ose 20 varet prej nevojave që kërkohen. Problemi që mua më shqetëson është se ne po ndërtojmë diçka nga 0, do të thotë prishim ambullanta të vjetra. Ndërsa, pyetja konkrete është pse nuk punon ambullanta në Shipitullë dhe në Mazgit.

Kryesuesi – Ju lutem mos dilni jashtë temës.

Lulzim Sadiku – Ju po bëni investime, po ndërtoni ambullanta të reja dhe unë konkretisht pyes pse nuk punojnë ambullantat që janë të ndërtruara. Poashtu, pse drejtoresha nuk jepë sqarim, por Nënkrjetari.

Kryesuesi – Ju do ta keni raportin e Ekzekutivit në muajin e ardhshëm dhe mund të bëni pyetje, por të mos humbim kohë se i kemi qytetarët këtu, në mbledhje.

Lulzim Sadiku - Unë e pashë nderin e respektin për qytetarët e Sibofcit, por pyeti konkretisht pse këto abullanta nuk janë funksionale, ndërsa ndërtohet ambullanta e re.

Labinot Mirena –Unë vetëm e përgëzoj z.Lulzim për marketing të mire.

Lulzim Sadiku – Për çka marketing të mirë.

Kryesuesi – Edhe ju z.Labinot keni dalë jashtë temës.

Fatmir Bektoshi – Kërkon që në vazhdimësi të procedohet kjo çështje në votim.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 16 vota për e miratuan Vendimin të barten 10 ari në emër të QKMF-së Obiliq (AMF-së Breznicë), nga parcela me nr. P-72602008-01189-0, në sipërfaqe prej 11053,0 m² e cila figuron në emër të Shkollës Filllore.

Pika e 4 e rendit të ditës

Kryesuesi – Ju njoftoj se numri total i vendimeve të Kuvendit komunal është 110.

Lulzim Sadiku –Te shqyrtimi i raportit të Kuvendit komunal, gjithsejt janë 108 vendime dhe prej tyre 15 vendime janë rishikuar. Këtu, kemi të bëjmë me një problem që pothuajse po na paraqitet çdo vit, por që kemi mbërri kulmin e vitit të kaluar derisa 108 vendime janë solide për punën tonë brengosëse dhe 15 vendime të rishikuara. Kjo do të thotë se në secilën mbledhje kemi nga një vendim të kthyer prapa, e 30 % të një vendimi, do të thotë 15 vendime të kthyer nga MAPL-ja.

Kryesuesi – Nuk janë 15 vendime sepse janë të rishikuara dhe nuk i bjen 30 %.

Lulzim Sadiku – 15 vendime i ke shkruar dhe unë thashë në çdo mbledhje nga një vendim dhe 30 % të një vendimi, do të thotë ne i kemi 12 mbledhje të Kuvendit komunal, ku për secilën mbledhje kemi nga një rishikim nga MAPL-ja dhe 0.30 % të një vendimi. Kjo do të thotë se janë 15 vendime të pabazauara në ligj, ose të kthyer prapa dhe mendoj se faji kryesor është te kryesuesi i Kuvendit dhe Kryetari i Komunës. Në fakt ne jemi bashkarisht ata që kemi lejue dhe kemi kërkuar të bëhen vendime të paligjshme. Unë kam një kërkesë tjetër që në këtë vit kalendarik Komuna, ta ketë përgjegjësin për çështje juridike dhe të mos bëjmë këso gabime që janë bërë. Këto vendime që po na i dërgoni ne duhet ti shohim në telefon dhe është vështirë sepse materialin nuk e kemi në mënyrë manuele. Pra, kërkoj që Kuvendi komunal ta ketë një njeri ekspert i cili do të udhëheqë me këto vendime, në mënyrë që mos të na kthehen 15 vendime për një vit. Kërkoj që të jemi shumë më vigjilentë dhe të mos na ndodhë më kjo, që ka ndodhë në vitin 2019.

Kryesuesi – Ju nuk keni nevojë të shikoni në telefon sepse i keni llap topët që ua kemi dhënë. Sa i përket vendimeve psh ne i kemi marrë 4 vendime për me i mbrojtë trungjet dhe kur janë rishikue janë bërë 8 vendime. Poashtu, ne kemi bërë edhe plotësim ndryshim të Rregulloreve dhe janë bërë më shumë vendime. Ne jemi njerëz që mund të gabojmë, por shumë mirë që është MAPL-ja, e cila na i kthen vendimet dhe ne i përmirësojmë.

Pika e 5 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit komunal për vitin 2020.

Lulzim Sadiku – Unë e përgëzoj Kryetarin e Komisionit që ka bërë një punë të shkëlqyeshme edhe pse dihet se ky plan bëhet për çdo vit dhe pëson pak ndryshime, aty ku është e nevojshme. Unë e përgëzoj Komisionin për punën e bërë me metodën më të mirë në kuadër të Rregulloreve dhe standardeve që i ka Kuvendi komunal.

Dragan Dancetovic – Mendoj se Kuvendi komunal në vitin e kaluar ka punuar mjaft mirë dhe po ndjehen përmirësime pozitive në Komunën tonë sepse ka rrugë më të rregulluara, rrugë më të ndriçuara dhe kërkojmë që në këtë vit tempoja e këtyre punëve të jetë më e shpejtë. Në këtë kuptim kam disa propozime sepse edhe më parë unë jam përpjekur për një zhvillim të barabartët të të gjitha mjediseve. Një prej prioriteteve duhet të jetë rregullimi i të gjitha rrugëve me një infrastrukturë përcjellëse.

Kryesuesi – Ju lutem të mos dalim jashtë rendit të ditës, të diskutojmë vetëm për planin e punës.

Dragan Dancetovic – Pikërisht qëndron këtu, problemi se unë kërkoj që këto kërkesa të mia të futen në planin e punës për vitin 2020. Pra, të bëhet komplet infrastruktura rrugore, ti kushtohet vëmendje e veçantë mjedisit sidomos në sezonin dimëror dhe nëse, ekziston mundësia që të shfrytëzohet energjia e ngrohtë nga Termoelektrana për ngrohje të familjeve, gjegjësisht për ngrohje dimërore. Poashtu, duhet të diskutohet edhe për problemin e papunësisë, që të rinjët të mos na largohen, të ketë programe më shumë në bujqësi, jo vetëm në mbjelljen e pemëve dhe perimeve, por edhe në përpunimin e tyre. Në fund të ndërtohen sa më shumë objekte sportive dhe fusha sportive për fëmijë e të rinjë dhe kjo është sa i përket pjesës praktike. Ndërsa, më duhet ta theksoj edhe një problem politik, që disa herë e kam theksuar por edhe më tej nuk është zgjidhur, që besoj se duhet të zgjidhet. Duhet të plotësohet vendi i zbrazët i zëvendëskryesuesit të Kuvendit dhe këtë e kërkoj sepse ekziston baza ligjore për plotësim të zëvendëskryesuesit të Kuvendit.

Kryesuesi – Sqaron se sa i përket 5 pikave të para Kryetari është në dijeni dhe është duke bërë një punë e madhe, prioritetet janë dhënë në vitin e kaluar dhe besoj se do të jenë në planin e punës së Kryetarit të Komunës. Ndërsa lidhur me zgjedhjen e zëvendëskryesuesit për komunitete, nga Kuvendi ai shkon automatikisht në Komunitat ku janë 10 % e qytetarëve, partia më e madhe nga komunitetet në mënyrë automatike e dërgon zëvendëskryesuesin për komunitete. Pra, Kuvendi komunal s'ka nevojë me marrë vendim fare sepse ligji e përcakton.

Nazmi Gashi – Unë kam qenë anëtar i grupit punues, i kam dhënë disa vërejtje dhe shpresoj se ato do të merren parasysh.

Kryesuesi – Gjithsesi, është jashtë planit që kemi diskutue dhe unë jam dakord, por sinqerisht është e tepërt me i thënë dikujt që 2 vjet, shko dil në fotografi për kartelë të identifikimit. Sot është dita e fundit dhe më nuk i them askujt.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal unanimitisht e aprovuan Planin vjetor të punës së Kuvendit komunal për vitin 2020.

Pika e 6 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet rekomandimet e KPF-së, kërkesat të cilat iu rekomanduan Drejtorive përkatëse për shqyrtim. Ndërsa, z.Fatmir Bekteshi ka kërkuar të na jepet informacion në mbledhjen e Kuvendit komunal për gurëthyesin i cili ka filluar të ndërtohet në Sibofc, si shqetësim i banorëve të Sibofcit.

Fatmir Bekteshi – Është e vërtetë se në mbledhjen e KPF-së, e kemi ngritë këtë çështje sepse unë e kam një kontakt me atë pjesë të banorëve atje dhe ata e kanë sjellë një kërkesë të unë.

Kryesuesi – E lus Nënkryetarin të na informoj lidhur me gurëthyesin në Sibofc, për çdo material që keni në mënyrë që ne si anëtarë të Kuvendit ta kemi një orientim se si të veprojmë, cilat masa duhet ti ndërmarrë Ekzekutivi në të ardhmen.

Ibush Mjekiqi – Duke ditur se Komuna e Obiliqit është një Komunë e vogël me sipërfaqe në aspektin territorial, territori i së cilës 72 %, është me interes nacional dhe kjo na vështirëson që ne të kemi zhvillime të ndryshme të aktiviteteve, apo shërbimeve për qytetarët tonë. Ne për operatorin në fjalë kemi marrë informacione në fillim të këtij viti sepse ai ka filluar të operoj, konkretisht të përgatitë terrenin për zhvillimin e aktiviteteve të veta. Reagimi ynë ka qenë i menjëhershëm përmes Drejtorisë së inspektoriatit që ia kemi ndaluar punimet nga se punimet ishin duke u zhvilluar në vendosjen e shtyallave për bartjen e rrymës elektrike deri në vendin ku ai ka mendue se do të zhvilloj aktivitetin e vet. Pra, ne ia kemi ndaluar dhe e kemi rrënue pjesën e bazamentit të trafos ku ai ka mendue me vendosë. Ne mendojmë se bashkarisht me ju ti drejtohem MMPH, Komisionit për Minjera dhe Minerale, i cili Komision këtë operator ekonomik e ka pajisë me licencë për hulumtim dhe aktivitet të punës së vet. Prandaj, punimet nuk do të vazhdojnë derisa ai të pajiset me leje pune sepse nuk ka leje pune për operim në Komunën tonë, ka vetëm licencë pune. Pjesa ku është mendue që ai ta zhvilloj aktivitetin i përfshin 3 zona kadastrale: zonën e Sibofcit, të Grabofcit dhe zonën e Shipitullës. Kjo zonë nuk është prone komunale, por është pronë e Agjensionit të pyjeve, me të cilin operatori ekonomik ka lidhë marrëveshje për shfrytëzim të asaj zone.

Fatmir Bekteshi – Unë kam kërkuar edhe në KPF, me na ardhë ndonjë material dhe sot ne nuk kemi pajisë me material, që askush nuk na dha ndonjë arsye pse nuk kemi pajisë me material. Tash, kërkoj të marrim një

rekomandim dhe Kryetari, Nënkryetari apo ndonjë drejtor të urdhëroj që neve me na pajisë brenda një afati të shkurtë me ato dokumente. Pra, ne duhet të nxjerrim një rekomandim që gjithsesi ai të mos e vazhdoj punën, pastaj të shohim.

Lulzim Sadiku – Kërkesën që e pashë që ka ardhë si kërkesë më duket nganjëherë si në botën e çudirave, të vjen diçka që thotë se ka licencë, çdo kompani, çdo operator ekonomik që i plotëson kriteret e automjeteve merrë licencë që punon dhe kontribon si operator ekonomik. Mirëpo, të vjen dhe të fillon punën, e të mos ketë asnjë vendim Drejtoria përkatëse, inspeksioni, Kryetari i Komunës, të jetë i saktë për atë pikë, vërtetë është shqetësuese. Ata banorë të asaj pjese jo vetëm që janë të shqetësuar dhe kanë protestue, por në fakt ata nuk kanë asnjë informatë. Unë mendoj dhe e din edhe drejtori i Bordit, e din edhe Kryetari i Komunës, e kryesuesi se asnjë kompani, asnjë operator ekonomik nuk mund të punoj pa e marrë lejen prej banorëve që është pjesa kryesore. Kjo do të thotë se duhet me marrë një nënshkrim, një besim prej asaj pjese të lokalitetit që të fillon me procedura. Ndërsa, ai vjen dhe fillon punën pa fillue asnjë procedurë, kjo është nonsense. Kërkoj që Kryetari i Komunës, Drejtoria përkatëse atij ti bëjë padi në Gjykatë për shkak se ka bërë shqetësim për ata qytetarë sepse licenca është diçka tjetër ndërsa leja është diçka tjetër. Unë dua të di se Komuna e Obiliqit, a ka lëshue ndonjë dokument për këtë operator.

Fatos Kurshumlija – Edhe ne si grup parlamentar i LDK-së, e shprehim shqetësimin për banorët dhe mendoj se janë mjaft ndotës në rajonin e Obiliqit. Mund të them se nuk është e nevojshme me pasë edhe një ndotës sidomos për zonën atje, të Qyqavicës. Poashtu, ne jemi pro çdo vendimi për me ia ndalu zhvillimin e veprimtarisë së gurëthyesit asaj kompanie atje.

Aziz Bici – Një gurëthyes aq afër vendbanimit me pluhurin dhe zhurmën e tij do ta vështirëson jetën e banorëve të këtyre fshatrave: Sibofc, Shipitullë, Grabofc, Zhilivodë si dhe do ta shkatërron infrastrukturën komunale. Ne nuk jemi kundër investitorëve, përkundrazi favorizojmë politika që thithin investitorë të cilët i kontribuojnë mirëqenies së qytetarëve. Në përgjithësi, Obiliqi dhe fshatrat përreth nuk kanë nevojë për investitorë në fushën e gurëthyesve, pasi që të njejtit krijojnë ndotje, zhurmë, shkatërrojnë ambientin dhe pamundësojnë jetën e banorëve rreth atyre lokaliteteve. Shqetësimi i qytetarëve është i madh dhe me vend sepse mbi kurrizin e tyre për përfitime personale të një kompanie, po rrezikohet shëndeti i tyre. Unë pasi që ta them propozim tim kërkoj nga ju kryesues që ti jepet fjala njerit nga përfaqësuesit të fshatit Sibofc. Ndërsa, propozimi im konkret që të votohet është që Kuvendi komunal në Obiliq, merrë vendim për ndërprerjen e hapjes së gurëthyesit në Sibofc nga kompania SB Construction, apo çdo kompani tjetër. Kuvendi komunal në Obiliq, duke u bazuar në këtë vendim obligon kompaninë që në vend ku është punue ta kthen gjendjen e mëparshme dhe Kuvendi komunal obligon inspektoriatin e Komunës, që të mbikqyrë në terren realizimin e vendimit.

Armend Rushiti – Në Komunën tonë operojnë disa kompani që vazhdimisht e degradojnë ambientin dhe e ndotin ajrin si janë fabrika e tullave në Mazgit dhe fabrika e asfaltit në Milloshevë. Vazhdimi i pajisjes me leje pune për mihje dhe gurëthues nga këto kompani në fshatin Sibofc, është vazhdim transparentë i korrupsionit pa pikë frige. Kompania në fjalë e dijmë se është në proces gjyqësor në Komunën tonë për shkak se ka ndërtuar pa lejen tonë objektin në fshatin Milloshevë.

Kryesuesi – Ju kur ta keni raportin financiar mund të diskutoni për këtë çështje, është Prokuroria dhe rastin mund ta denononconi.

Armend Rushiti - Edhe pse kemi probleme ligjore me këtë kompani Kryetari z.Xhafer Gashi bashkë me Zyren e Prokurimit, ata i kanë shpërblye me tender milionësh dhe shtrohet pyetja si ka mundësi një kompani që është në proces gjyqësor në Komunën tonë, e njejtja kompani fiton tendere kudo ne territorin e Komunës tonë. Ata morën krejtë çka deshtën nga Komuna jonë sheshin, rrugën e çka jo tjetër dhe tash dëshirojnë përveç korrupsionit dhe zhvatjes që po i bëjnë Komunës, po tentojnë edhe mjedisin të na shkatërrojnë. Këtu, ka dyshime të mëdha si zytari i lartë i Komunës, i Ekzekutivit direkt është lidhur me këtë kompani dhe këto janë interesa personale, që në këto dyshime ne kemi bërë edhe kallëzime dhe presim që drejtësia ta thotë fjalën e vet. Ne si LB, qëndrojmë fuqishëm në anën e drejtësisë dhe interesit të qytetarëve të Sibofcit, ne

jemi me banorët e Sibofcit dhe të gjithë Komunës tonë. Prandaj, i mbështesim qytetarët e Sibofcit, pse jo edhe të Milloshevës, kundër lejes së punës të kësaj kompanie dhe ftojmë organet e drejtësisë të veprojnë në mbrojtjen e mjedisit, dhe qytetarëve kundër këtij pushteti të korruptuar.

Nazmi Gashi – Është e çuditshme sepse jemi zënë në befasi dhe nuk kemi kurrfarë dokumenti para vetes, nuk e dijmë kush është operatori, nuk e dijmë çka po don, nuk e dijmë në cilin vend ose pjesë është ku ka vendosë ajo kompani me punue. Neve, që na shfrytëzojnë që 50 vjet, 300 vjet, të gjithë e dijmë edhe me qymyr dhe të gjitha të mirat që i kemi pasë na i kanë marrë të tjerët. Poashtu, ne kur jemi mundue me bë diçka nuk na kanë lënë dhe unë e di se para 50 vjete, nuk na lejonin me nxjerrë thëngjill në vendin tonë. Tash, kemi gurë që na i ka dhuru natyra, por nuk po dijmë me i shfrytëzu, normal që Qyqavica ka mjaft gurë dhe shërbimi i atyre gurëve është për infrastrukturë dhe rrugë. Ne duhet të dijmë se çka po përfitojmë prej këtij operatori i cili po i merrë këto të mira në vendin tonë. Prandaj, është mirë me na kompletue me dokumentacion, me ditë projektin, me ditë programin e punës, përmes cilit segment ka ardhë, cili institucion shtetëror ia ka dhënë mundësinë për operim të punës, sa ndotet ambient etj. Mendoj se kësaj radhe situata do të jetë më e qartë për qytetarët e Obiliqit dhe Sibofcit sepse ajo që nuk është e ligjshme nuk kalon pasi që nuk është në interes të askujt.

Hysni Mjeku – Ne edhe në KPF, e kemi shqyrtuar kërkesën tuaj, por dua të them se ky Kuvend është zotue se duhet ti jepet përparësi bizneseve në këtë Komunë. Mirëpo, jo atyre bizneseve që na shkaktojnë trauma dhe na dëmtojnë edhe florën e faunën që edhe ashtu e kemi shumë pak. Të nderuar kuvendarë, ju e dini shumë mirë se kemi nënshkruar disa marrëveshje me 4 Komuna, që në atë pjesë të gravitoj interesi së pari i qytetarëve tonë, pastaj ti lejohet një operatori për gurëthyes. Mendoj se duhet të kërkohet nga Kryetari dhe Ekzekutivi që ne të kemi ndonjë dokument të lëshuar nga organet e këtij Kuvendi. Në mbledhjen e KPF-së, nuk kemi pasë një elaborat të tillë, por vetëm i kemi dhënë drejtim që kjo çështje të vjen në Kuvend. Kërkoj që punimet e këtij operatori që nga sot të ndalohen, njëkohësisht nëse pa pëlqimin e organeve komunale gjegjësisht të Kryetarit ka filluar punimet duhet të ngritet edhe procedurë penale për shqetësimin e këtyre qytetarëve, jo vetëm të Sibofcit sepse aty gravitojnë edhe qytetarët e Shipitullës dhe të Grabofcit. Herave tjera, nuk duhet të na vëni para aktit të kryer në Kuvend sepse brenga e qytetarëve është edhe brengë e jona, nga se ne jemi këtu për ti mbrojtë së pari qytetarët pa i anashkaluar procedurat dhe rregullat ligjore. Unë besoj se Drejtoria e inspeksionit dhe ajo e ambientit e kanë kryer punën e vet, por derisa nuk kemi diçka të shkruar fjalët i merrë era. Ne pavarësisht nuk do të jemi vetëm në interesin e një komuniteti, por kudo që mund të qfaqen shqetësimet ne do të jemi pranë qytetarëve sepse për këtë jemi këtu të thirrur. Ky Kuvend duhet sot të merrë vendim që plotësisht ti ndërpriten punimet dhe pasi që nuk kemi dokumente nëse, nuk ka pasë kontakte me Kryetarin e Ekzekutivin, atëherë të kalohet edhe në procedurë penale sepse qytetarët janë të shqetësuar dhe të traumatizuar. Ne ju kërkojmë falje qytetarëve për gjendjen në të cilën janë dhe shpresoj se Kryetari bashkë me Ekzekutivin dhe me këtë Kuvend, nuk do ta lejojnë në gjë të tillë.

Fatmir Bektashi – Unë e bëra edhe një pyetje pse nuk na është sjellë diçka kur e kemi mbajtur KPF-në, të hënë ndërse sot është e premtë, pse nuk kanë ecë në këtë drejtim të paktën që të pajisemi se kush është firma, a ka ndonjë pëlqim dhe kush e ka dhënë atë pëlqim. Unë e kam parë një dokument, që sot nuk e kam me vete dhe sot është dashur Ekzekutivi të japë raport, pse nuk jepë përgjegjësi Ekzekutivi, Drejtoria përkatëse.

Aziz Bici – Edhe një herë propozoj që mundësisht të ju jepet fjala përfaqësuesve të fshatit Sibofc. Kjo është një praktikë, që nuk është për herë të parë dhe ju e dini se në vitin e kaluar në njërin nga seancat ua kemi dhënë fjalën banorëve. Mendoj se derisa kanë ardhë dhe kanë pasë durim të presin na kishin ndihmue, por është edhe në interes tonin me i dëgjue shqetësimet e tyre. Unë po e lexoj edhe njëherë nenin 37 sepse doli pak si e dyshimtë se çështja nuk është në kompetencën tonë. Pra, neni 37, lidhur me kompetencat komunale pika 1.1 zhvillimi lokal ekonomik, 1.2 planifikimi urban dhe rural, 1.3 shfrytëzimi i tokës zhvillimi 1.4, zbatimi i Rregulloreve për ndërtimet standarde për kontrollimin e ndërtimeve, pika 1.5, mbrojtja e mjedisit lokal. Neve, mund të na jepni kohë që ne grupet e subjekteve politike për 10 minuta, që ta përpilojmë një vendim dhe ta hudhim në votim, jo vetëm këtij operatori me ia ndalue punën, por çfarëdo operatori që bën

kërkesë në atë zonë ti ndalohej puna për 2 arsye. E para, sepse Komuna jonë vetëm atë pjesë në afërsi e ka të pyjet për gjelbërim dhe ambient të mirë dhe e dyta që e përmendi parafolësi po bjen në kontraditë memorandumi i bashkëpunimit me 4 Komuna, që ne e kemi votue, dhe që absolutisht nuk ka ardhë në shprehje me mendue, që një biznes si gurëthyesit ti jepet leja ose të lejohet me operue.

Kryesuesi - Unë mund të ju japë fjalën qytetarëve, por nuk është praktikë në Kuvend kur debatohet dhe ne nuk jemi pajisë me dokument nga se nuk ka pasë dokument të shkruar dhe për këtë arsye Drejtoria e inspektoriatit i ka mbyllë punimet. Z.Aziz, ne vendim që na kushton nuk guxojmë të marrim. Ne duhet të pajisemi me dokumente, në mënyrë që të shohim se çfarë hapa të ndërmarrim më tutje. Ne nuk guxojmë të marrim një vendim që nesër mund të na kushtoj me miliona sepse nëse, MMPH apo Komisioni i Pavarur për Minjera dhe Minerale e ka pajisë me leje për operim, mundet me na padit. Ne mund ti marrim masat më të lehta që janë në përgjegjësi të Kuvendit dhe pa na informue Ekzekutivi i Komunës, komplet me dosje ne s'mund të marrim vendim. Propozoj të nxjerrim një rekomandim që Ekzekutivi nga Ministrinë e linjës të na informoj për rastin në fjalë, mos me lëshue leje të operimit dhe në mbledhjen e radhës raportin komplet me na sjellë me detyra dhe përgjegjësi që kemi.

Ibush Mjekiqi – Ne nuk duhet të ngutemi me hapa dhe nëse, ka nevojë jo me pritë fundin e shkurtit, por ne jemi këtu, edhe me organizue debat me qytetarë për mbledhje të jashtëzakonshme për me nxjerrë vendim.

Është shumë mirë që e keni inicue nga mbledhja e KPF-së, që kjo çështje të futet në rend dite për arsye se shqetësimi është shumë i madh i atyre banorëve të zonës, por qysh po shihet edhe i zonave tjera. Sot kërkoj nga ju të mos merrni vendim sepse ashtu është qysh u tha se mund të ketë pasoja juridike, por të marrim rekomandim që ti drejtohem Ministrisë së ambientit dhe Agjensionit të pyjeve, le të na kthejnë përgjegje. Pastaj konform asaj përgjegjeje ne do të marrim vendim në Kuvend. E rëndësishme është se punimet janë ndërprerë dhe ato nuk mund të vazhdojnë pa u sqaruar kjo procedurë.

Sherif Hoti – Kryesues, tema nuk ishte kjo çfare e përmendi zotëriu sepse Kryetari nuk i kryen procedurat e Prokurimit, por Zyra e Prokurimit edhe pse ai e potencoi se Kryetari në bashkëpunim me Prokurimin kanë lidhë kontratë, kjo nuk është e vërtetë. Zyra e Prokurimit, gjatë hartimit të kriterëve kërkon nga operatorët ekonomik në rastin konkret që të ketë licencë për bazën e asfaltit, që për Zyren e Prokurimit kompania në fjalë e ka bazën e asfaltit, e ka licencën nga Ministria përkatëse dhe çdo gjë është në rregullë. U përmendë se kompania është e denuar, apo iu është ngritë një kallëzim penal dhe Zyra e Prokurimit kërkon nga të gjithë operatorët ekonomik, që të sjellin vërtetimet nga Gjykata dhe këtë vërtetim Zyra e Prokurimit e posedon se kompania nuk është as e ndjekun, as e denuar. Këtë dokument mund të ua dëshmoj juve, kur të dëshironi.

Lulzim Sadiku – Unë i bëra 5 pyetje, por asnjë përgjegje nuk mora, pyeta çka ka prej dokumenteve Kuvendi komunal, zyra e inspeksionit a ia ka ndalu punën, a ka bërë raport, pse nuk na kanë ardhë materiali sepse qe 5 ditë, është mbajtë KPF-ja. Kërkesa ime për votim është të merret vendim që të ndërprehen punimet në atë zonë për të cilën po flasim.

Muhamet Mustafa – Shumë me vëmendje i dëgjova diskutimet, por s'jam i sigurtë nëse ka ndonjë kërkesë prej atij operatori ekonomik drejtuar Kuvendit komunal, për operim në atë zonë. Inspeksioni shumë mirë e paska kryer punën e vet, e ka vendosë shiritin dhe i paska ndaluar punimet. Tash, çfarë vendimi mund të marrim ne kur nuk kemi asnjë kërkesë, pse të kërkojmë dokumente nëpër Ministri, atje kur neve nuk na është drejtuar askush. Nëse, është i interesuar operatori pasi që ju kanë ndalë punimet, atëherë ai me siguri do ti drejtohet Komunës, për leje të ndërtimit.

Kryesuesi – Ne vendim nuk mund të marrim sepse Komisioni për Minjera dhe Minerale, atij diçka prej dokumenteve i ka lëshue.

Hysni Mjeku – Propozoj të marrim vendim për ndërprerje të punimeve, deri në krijimin e rrethanave të reja.

Ibush Mjekiqi – Punimet janë ndërprerë dhe absolutisht asnjë aktivitet nuk do të vazhdon aty. Unë nuk ju preferoj të merrni vendim, por rekomandim dhe konform përgjegjeve të Ministrive përkatëse, ju do të pajiseni me dokumentet që ajo kompani i posedon. Unë sa e di Kryetari ka pasë takime me banorë dhe nëse,

është e nevojshme bëhet edhe peticioni prej tyre, rekomandimi juaj dhe të gjitha këto dokumente javën e ardhshme i shkojnë Ministrisë. Pastaj, ne marrim përgjegje prej Ministrisë dhe jemi këtu, për me shqyrtue.

Nazmi Gashi – Pyeti se a ka marrë vendim inspeksioni për ndërprerje të punëve.

Ibush Mjekiqi – Përgjegjet po.

Aziz Bici – Unë qysh e kuptova Nënkyetarin, në rast se e merrë lejen apo pëlqimin prej Ministrive përkatëse, atëherë sigurisht se me shumicë do të votohet dhe prej Komunës, atij operatori do ti lejohet me veprue. Ndoshta, e kam keqkuptue por propozimi i Nënkyetarit është se ne duhet të presim dokumente prej operatorit që ai ka fillue atë punë atje, nga Ministrinë përkatëse. Unë po them çfarëdo Ministrie, që i jepë leje, apo pëlqim ne si Kuvend komunal kemi mundësi me i pengue dhe mos me ia lejue atyre Ministrive përkatëse.

Ibush Mjekiqi – Unë nuk mund të paragjykoj se çfarë përgjegje vjen prej Ministrive përkatëse, por pavarësisht përgjegjes qoftë pozitive, ose negative ne jemi këtu me i ndërmarrë të gjitha hapat ligjore bashkarisht.

Aziz Bici – Në rast se është lëshue pëlqim prej Ekzekutivit, duhet të na njoftoni neve, atëherë edhe unë them të presim, por nëse nuk është lëshue pëlqimi ne e kemi mundësinë qysh sot me marrë vendim.

Kryesuesi – Ne i kemi 2 propozime, propozimin e LVV-së dhe PDK-së, që të marrim vendim dhe propozimin tjetër të marrim rekomandim.

Kryesuesi e hudhi në votim propozimin e parë dhe anëtarët e Kuvendit komunal votuan me 9 vota për, 10 vota abstenim dhe 1 votë kundër. Ndërsa, për propozimin e dytë me 11 vota për dhe 1 votë abstenim u miratua Rekomandimi me të cilin obligohet Ekzekutivi i Komunës, të marrë informata të sakta nga Ministrinë përkatëse MMPH, KPMM, APK lidhur me gurëthyesin në Sibofc dhe ti pajisë anëtarët e Kuvendit komunal me dokumentacion për rastin në fjalë.

Kryesuesi – Paraqet kërkesën e DSHPE-së, për plotësim të vendimit nr.I-113, të dt.28.06.2019.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 16 vota për e miratuan Vendimin Të plotësohet pika e dytë e vendimit nr.I-113, të dt.28.06.2019, si në vijim: Lokacioni ku do të vendoset trafoka është në parcelën P-72614044-01436-0 ZK, Obiliq, pronë shoqërore në sipërfaqe prej 18685 m² dhe nga parcela e cekur më lartë duhet të ndahen 8.10 x 4.20 m² (34.02 m²).

Kryesuesi – Paraqet kërkesën nga MAPL-ja, për rishikim të vendimit për tatimin në Pronë.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 14 vota për dhe me 2 vota abstenim e miratuan Vendimin mbi Tatimin e Pronës së Paluajtshme për vitin 2020.

Pika e 7 e rendit të ditës

Hysni Mjeku – Unë e kam një kërkesë, që është si lloj ankese prej 3 qytetarëve nga fshati Shipitullë, nga Ardiani, Bekimi dhe Adnani. Këtu, bëhet fjalë për disa ndërtime që unë i quaj objekte ndihmëse, te Ardiani në hyrje të dyerve të tyre është ndërtuar një garazhë për veturë, te Bekimi është një pllakë e betonit brenda oborrit dhe te Ardiani është një barakë montimi para shtëpisë së tij. Këta, pajtohen që të pajisen me leje ndërtimi, ose të hiqet masa e ekzekutimit sepse supozohet se do të rrënohen këto 3 objekte. Këta, pajtohen që edhe përmes noterit të bëjnë marrëveshje, që nëse vjen deri te eksproprijimi ose dislokimi i këtyre objekteve, ne do ti marrim përsipër të gjitha shpenzimet. Vendimi është i muajit nëntor të vitit të kaluar, ndërsa duhet të ekzekutohet me dt.4 të muajit që vjen. Kërkesa ime është që këto objekte ose të legalizohen, ose të ju jepet një afat i përkohshëm sepse vërtetë janë të shqetësuar, pasi që sado pak kanë investue. Pra, unë kërkoj që Drejtoria e inspeksionit këtyre qytetarëve, të ju bëjë një zgjidhje sepse janë rrethana specifike dhe janë brenda oborrit të shtëpisë. Unë nuk e di se qysh e ka marrë për bazë drejtori i inspeksionit me të rrënimin e këtyre objekteve.

Kryesuesi – Mua, sot më ka ardhë kjo kërkesë, por një kërkesë të tillë ne para 2 muajve ia kemi rekomandue DPUKP. Ne në vitin e kaluar e kemi nxjerrë një vendim se i lejohet leja e ndërtimit në ato zona kadastrale, në të gjitha ato zona kadastrale të cilat nuk preken nga zhvillimet minerale në 40 vitet e ardhshme. Unë jam duke e parë se ai vendim është duke u refuzuar nga Ekzekutivi. Mendoj se më mirë është me na sjellë dhe me na tregue se kjo nuk zbatohet. Ata njerëz kanë të drejtë të pajisen duke u nisë nga

Obiliqi, Palaj, Lajthishtë, Sibofc, Hade dhe Shipitullë, do të thotë se duhet të respektohet ai vendim. Përkundrazi nëse, ka rezistencë nga Ministria e mjedisit le të na sjellin me rishqyrtue çështjen dhe ne do ta rishqyrtojmë.

Ibush Mjekiqi – Ju njoftoj se sot në takimin e mëngjezit ishte kërkesa e njejtë drejtuar Këshillit të drejtorëve dhe Kuvendit. Drejtoria e inspektoriatit ka pasë takime me ata dhe poashtu, edhe Kryetari ka zhvillue takim me këta 3 persona, të cilët janë në këtë proces. Është shumë e vërtetë, atë që e tha z.Hysni Mjeku, se të gjitha këto janë anekse, por z.Hysni nuk potencoi diçka se muret e 2 garazhave kanë qenë të ndërtuara para vitit 2015, kur ka ardhë deri te ndërprerja e punimeve. Është shumë e vërtetë, vendimi që u tha se duhet të zbatohet nga ana juaj, të kufizohet ose zgjerohet zona e ndërtimit për 40 vitet e ardhshme, që të ju lejohet banorëve jo vetëm Shipitullës por të gjitha zonave kadastrale që nuk e atakon zonën e cila është 72 % interes nacional. Këtu, ekzekutimi nuk bëhet me dt.4, z.Hysni Mjeku sepse involvohen disa sektorë duke filluar edhe prej asistencës së policisë dhe vendimi është shtyrë deri me dt.10, sepse policia ka kërkuar sepse nuk mund të bëjë asistencë. Ne brenda këtyre 10 ditëve, do të bëjmë gjithçka që është e mundur që këto objekte mos të hyjnë në proces të rrënimt, por nëse është e nevojshme duhet të rrënohen jo vetëm këto, por edhe objektet tjera sepse asnjë inspektor, asnjë kuvendar nuk shkon në burg për një veprim të papërgjegjshëm të dikujt.

Nazmi Gashi – Inspeksioni punon në bazë të ligjit, Rregulloreve dhe shkresave administrative. Ne sot nuk kemi të kompletuar sepse nuk e kemi një vendim të inspeksionit se në çka janë bazue dhe çka shkruan në atë vendim. Argument i punës së inspeksionit është vendimi që e ka nxjerrë dhe ne si anëtarë të Kuvendit komunal, sikur ta kishim vendimin e inspeksionit do ta kishim analizue. Unë nuk besoj se inspeksioni jonë nxjerrë ndonjë vendim me tendenca sepse nuk ka arsye, por është i detyruar dhe ne me marrë vendim kundër vendimit të inspeksionit është mjaft telashe. Mendoj se është mirë njerëzit me i këshillue, janë format administrative si të veprohet, por ne kërkojmë që Drejtoria e inspeksionit të merret edhe njëherë me rastin në fjalë, se a mund të gjejë ndonjë afat, apo mënyrë tjetër të zgjidhjes së problemit.

Hysni Mjeku – Ju garantoj, se këto raste në Komunën tonë i kemi me qindra psh Kuvendi komunal i Drenasit, thotë se me qindra rrënime do ti bëjmë. Mbi të gjitha, unë nuk jam për me ndërhy në dispozita ligjore, por mundësisht të ju jepet një afat këtyre njerëzve, që me ju ndihmue të gjithëve njësoj.

Kryesuesi – Propozoj ti rekomandojmë Ekzekutivit, që të bëhet një zgjidhje në kuadër të hapësirës ligjore dhe në këtë mënyrë të bëhet një zgjidhje për ata banorë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 16 vota për i Rekomanduan Ekzekutivit të Komunës, për objektet e ndërtuara në Shipitullë që në kuadër të hapësirës ligjore të bëjë zgjidhje për çdo familje veç e veç.

Hysni Mjeku – Unë e kam edhe një kërkesë, tash, nuk më kujtohet se në cilën seancë kemi marrë vendim për një pjesë të arësimitarëve, që kanë shkue në pension dhe sot e tutje, nuk është zbatue vendimi i Kuvendit komunal. Në bazë të bisedave që kam zhvillue me shumë arësimitarë, unë sot po e përkrahu vendimin dhe kërkesën e Kryetarit i cili është pajtuar me kërkesën e mësimdhënësve, të cilët kanë parashtruar ankesë në Gjykatë. Do të thotë i kanë tërheqë kërkesat e tyre dhe janë në gjendje të deklarojnë publikisht me shkrim para Drejtorisë së Arsimit, se i kanë tërheqë kërkesat nga Gjykata. Meqë, ka kaluar një kohë bukur e gjatë pasi që kemi edhe buxhet të mjaftueshëm, konsideroj se kësaj radhe duhet të zbatohet vendimi sepse të gjithë kemi qenë pro këtij vendimi. Mendoj se shumë mjete të vogla janë ato që duhet ti marrin në krahasim me kontributin e dhënë. Kërkoj që drejtori i Arsimit, ta ketë parasysh vendimin e Kuvendit komunal, që e kemi marrë, që të gjithë atyre mësimdhënësve, të cilëve nuk ju është paguar të ju paguhen 3 paga personale gjatë shkuarjes në pension.

Kryesuesi – Ju e dini se kontrata kolektive nuk është obligim ligjor, por është vullnet i Komunave, që në këtë rast ishte vullneti i Kryetarit të Komunës, për këtë çështje. Sipas ligjit këtë të drejtë e gëzojnë në bazë të marrëveshjes vetëm ata mësimdhënës, që janë në mesin e të gjallëve.

Hysni Mjeku – Është skandaloze sepse edhe ai që ka vdekë ka lënë bashkëshorten dhe fëmijët.

Ibush Mjekiqi – Unë e kuptoj vullnetin tuaj për pagat jubilarë që të paguhen pas pensionimit. Për Ekzekutivin dhe poashtu, edhe për juve nuk është problematike masa e parave sepse kemi para, por vetëm jemi duke pritë në raste të veçanta që të gjendet rruga administrative ligjore. Mendoj se nuk janë shumë raste që kanë mbetë, janë 13 raste dhe Kryetari, drejtori i Arsimit dhe unë kemi kontraktue me ata, por vetëm duhet të gjendet rruga administrative, për shkak të procesit të auditimit që bëhet.

Muhamet Mustafa – Operatorit ekonomik i cili e ka fitue tenderin për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve, po hudhë nëpër rrugë, asfalt, rërë me fraksion bukur të trashë deri në 1 cm. Unë kam një kërkesë për DSHPE-në, për menaxherin i cili e kontrollon atë projekt që mos të hudhë rërë me strukturë të trashë sepse mua ma ka thye xhamin e përparmë të veturës. Ne kemi problem çdo ditë sidomos prej Milloshevës, kur kalon andej e shehë se trotuari është mbushë plot rërë të trashë dhe me lopata mund ta heqësh rërën anash. Unë nuk besoj se specifikimi teknik i atij tenderi është bërë me hudhë rërë.

Naim Miftari – Sqaron se kjo është rrugë magjistrale, që menaxhohet nga Ministria e infrastrukturës, e jo nga Komuna.

Kryesuesi – Në mbledhjen e fundit është bërë një akuzë ku thuhet se në konkursin e fundit, njerëzve me shkolla private ju kanë dhënë bursa, por ka ardhë një raport, është Komisioni dhe emrat janë publik. Komisioni që e kemi formue ne e kanë sjellë listën e përfituesve të bursave, prandaj nuk është mirë me akuzue pa bazë sepse fjala publike e ka peshën e vet. Unë mund të them se kjo listë është kontrollue dhe asnjë nuk është gjetë me fakultet privat.

Hysni Mjeku – Te ndarja e bursave dhe shpenzimet e udhëtimit për nxënës, mendoj se Rregullorja duhet të shqyrtohet dhe plotësohet në mënyrë që të del një Rregullore sa më e mirë.

Kryesuesi – Sqaron se kur e bëjmë planin e punës, i caktojmë plotësim ndryshimet e Rregulloreve, por vitin e kaluar ne 2 herë e kemi ndryshuar dhe plotësuar atë Rregullore dhe më nuk pranoj nga Drejtoria e Arsimit, sponsorizim të Rregullores së tillë. Ju e dini se Drejtoritë i kërkojnë Rregulloret ndërsa ne veprojmë sipas nevojës së tyre.

Ibush Mjekiqi – Është e vërtetë se Rregullorja 2 herë ka ardhë në Kuvend, vitin e kaluar për plotësim dhe plani ynë është që sa më shpejt përmes Drejtorisë së Arsimit dhe Kuvendit me një Komision të shqyrtohet edhe njëherë sepse ka mangësi. Unë po i përmendi 2 mangësi, sepse më së shumti është përballë Komisioni që e ka bërë ndarjen e bursave. Një prej tyre është heqja e shpenzimeve për nxënës për Shipitullë dhe lagjen Mavriqi sepse në Shipitullë këtë vit shkolla nuk funksion. Poashtu, lëshim tjetër në Rregullore ka qenë dhënja e bursës për doktoraturë dhe në bazë të nenit që e ka përcaktue këtë çështje, ne nuk kemi pasë mundësi asnjë personi me i dhënë bursë sepse ka qenë vetëm për institucionin publik, ndërsa doktoratura bëhet edhe në institucione të huaja, jashtë vendit.

Kryesuesi – Është nder për Obiliqin, me pasë një doktor shkence pavarësisht se cilës lëmi i takon. Komisioni duhet ta trajtoj këtë Rregullore, por pas planit të punës të cilin do ta punojmë bashkarisht.

Mbledhja përfundoi në ora 12:51'

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli



Kryesuesi i Kuvendit komunal


Burim Gërguri